

Cila gjykatë është kompetente për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore?

Gjykata komunale është kompetente për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore nga një gjyqtar i vetëm. Në pikëpamje territoriale do të jetë kompetente ajo gjykatë në juridiksin e së cilës trashëgimlënësi në kohën e vdekjes ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin e vet.

Si mund të disponojnë trashëgimtarët me pjesën e tyre trashëgimore?

Sipas ligjit për Barazi Gjinore N. 2004/02, nen 16.13 trashëgimtarët, femra dhe mashkujt mund të disponojnë me pjesën tyre trashëgimore dhe ta tjetërsojnë, sipas regjistrimit si pasuri e tyre trashëgimore.

Disenjoi Erodita Klaiqi Kasumi
Designed by



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilane
Gilan Belediyesi

Njih të drejtat tua të trashëgimisë dhe pronës



KUVENDI KOMUNAL GJILAN
Njësija për të drejtat të njeriut
Zyrtarja komunale për Barazi gjinore
Drita Klaiqi

Tel: 044 873 203

Qasja grave nē tē drejtēn pronësore dhe nē tē drejtēn trashëgimore, éshtë një ndër temat që nē Kosovë gati kurrë nuk diskutohet. Rrethanat socio-kulturore, kanë ndikim ma tē madh se sa aktet ligjore. Statistikat gjyqësore tregojnë se nē praktikë aplikimi i ligjit sa i përket rasteve kur mohohet çështja e së drejtës përkatëse, éshtë mjaft e rrallë. Situatat e tillë janë rënduese pér femrat tē cilat kërkijnë që tē drejtat e tyre tē promovohen, mbrohen dhe tē përmbytshen.

Çka nënkuptojoj me termin trashëgimi?

Trashëgimia éshtë kalimi me ligj a me testament i pasurisë së dikujt që vdes pasardhësve tē tij.

Si fitohet trashëgimia?

Me ligj zbatohet ku trashëgimlënësi nuk ka lënë testament ose ka lënë testament vetëm një pjesë tē pasurisë së tij ose kur testamenti éshtë pjesërisht i pavlershëm.

Kush janë trashëgimtarët ligjor nē mungesë tē testamentit?

Sipas nenit 11 tē ligjit mbi trashëgiminë, trashëgimtar ligjor janë: fëmijët e trashëgimlënësit tē adaptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshortja, prindërit, vëllezërit dhe motrat dhe pasardhësit e tyre.

Si ndahet pasuria trashëgimore kur vdes njëri bashkëshort?

Pasuria trashëgimore e tē vdekurit trashëgohet para tē gjithëve nga bashkëshorti i tē vdekurit dhe nga fëmijët.

Këta trashëgojnë pjesë tē barabarta dhe paraqesin radhën e parë tē trashëgimisë pa dallim gjinie, gjithashtu fëmijë nënkuptojmë djemtë dhe vajzat.

Po nē qoftë se njëri nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit?

Atëherë pjesa pasurisë trashëgimore që do t'i takonte fëmijës së vdekur sikur tē kishte jetuar pas trashëgimlënësit do tē trashëgohet nga fëmijët e tij apo nipat a mbesat e trashëgimlënësit nē pjesë tē barabarta.

Po nëse trashëgimlënësi nuk ka fëmijë, kush e trashëgon pasurinë e tij?

Pasuria e tillë ndahet nē dy pjesë tē barabarta d.m.th gjysma e pasurisë u takon prindërvë dhe gjysma tjetër bashkëshortit.

Në qoftë se pas tē vdekurit nuk ka bashkëshort, atëherë prindërit e tē vdekurit e trashëgojnë tërë pasurinë nē pjesë tē barabarta dhe kjo paraqet radhën e dytë tē trashëgimisë e cila vjen në shprehje vetëm nëse nuk ekziston radha e parë e trashëgimisë.

Po nëse dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur dhe nuk kanë lënë pasardhës?

Në këtë rast tërë pasurinë trashëgimore tē trashëgimlënësit e trashëgon bashkëshortja ose bashkëshorti i tij apo i saj.

Si trashëgohet pasuria nëse njeri nga prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur dhe trashëgimlënësi nuk ka fëmijë?

Në këtë rast pjesën trashëgimore që do t'i kishte takuar njërit prind, sikur tē kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë fëmijët e tij (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit) nē pjesë tē barabarta.

Po nē rastin kur trashëgimlënësi ka qenë adoptues?

Atëherë i adaptuan dhe pas lindësit e tij, ndaj adoptuesit kanë tē drejta tē njëta trashëgimore, sikurse fëmijët e adaptuesit dhe pas lindësit e tjerë tē tij, përveç nëse nē rastin e adoptimit, këto tē drejta nuk janë tē kufizuara ose përjashtuar fare.

Çfarë tē drejte ka bashkëshorti i trashëgimlënësit nga pasuria e përbashkët e fituar me punë gjatë martesës?

Bashkëshorti i trashëgimlënësit ka tē drejtë tē kerkojë që nga pasuria trashëgimore tē veçohet pjesa e tij/saj nē pasunën e përbashkët, tē cilën bashkëshorti e kane fituar me punë gjatë martesës. Pas ndarjes së pasurisë së përbashkët vetëm pjesa që i takon trashëgimlënësit bëhet objekt i trashëgimisë.

Çka ndodhë nē rastin kur trashëgimlënësi ka jetuar nē bashkësinë jashtëmartesore?

Në këtë rast duhet t'i kenë tē plotësuara dy kushte:

1. Që bashkësia jashtëmartesore gjer nē momentin e vdekjes së trashëgimlënësit tē ketë zgjatur së paku 10 vite e nē këtë bashkësi ka së paku 5 vjet.
2. Që asnjëri, as tjetri bashkëshort tē mos ketë genë nē martesë me personin e tretë respektivisht që trashëgimlënësi ka qenë nē martesë tē ketë ngritisur padi pér shkurorëzim ose anulim tē martesës dhe pas vdekjes së tij tē konstatohet se padia ka pasur mbështetje.

TRASHEGIMIA